



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2 dhe 6, të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2020, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe “AL TRADE HOLDING” LLC
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 01360-1, Certifikata e pronësisë nr. P-71914075-01360-1, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 00220-21, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00220-21, parcela kadastrale nr. 00221-11, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00221-11, parcela kadastrale nr. 00221-12, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00221-12, parcela kadastrale nr. 00237-1, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00237-1, parcela kadastrale nr. 00237-2, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00237-2, parcela kadastrale nr. 00237-4, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914075-00237-4, parcela kadastrale nr. 00237-5, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914075-00237-5, pjesë e parcelës nr. 00238-6, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914075-00238-6, pjesë e parcelës nr. 00238-8, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914075-00238-8 në pronësi të Bajram Gashanit dhe pjesë e parcelës nr. 00219-1, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00219-1, në pronësi të “AL TRADE HOLDING” LLC.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Prishtina e Re, Zona Perëndim” në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-58587/20 , më 11.03.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

